



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 tetor 2017  
Nr. ref.: RK1135/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI44/17**

Parashtrues

**NTP “Theranda - Projekt”**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktvendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime  
A. nr. 503/2006 ATK,  
të 17 shtatorit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ndërmarrja Tregtare-Prodhuese “Theranda-Projekt” nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), e cila përfaqësohet nga avokati Ymer Kubati, në bazë të autorizimit të lëshuar nga drejtori i parashtruesit të kërkesës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime në procedurën e sërishme A. nr. 503/2006 ATK, të 17 shtatorit 2013, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe ishte vërtetuar Vendimi i Departamentit të Ankesave nr. 292/2006, i 4 gushtit 2006.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur një numër i normave ligjore që nuk janë të lidhura me shkeljet kushtetuese.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenet 21. 4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 13 prill 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 26 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të plotësojë formularin e kërkesës dhe të dorëzojë autorizimin.
8. Më 20 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin dhe formularin e plotësuar të kërkesës.
9. Më 7 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 28 mars 2006, Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin e mëtejme: ATK) zbatoi kontrollin e afarizmit tatimor të parashtruesit dhe lëshoi njoftim për auditim dhe rivlerësim, sipas të cilave parashtruesi është ngarkuar me obligime tatimore në një shumë të caktuar.
11. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Departamentin e Ankesave të ATK-së kundër njoftimit për auditim dhe rivlerësim.

12. Më 4 gusht 2006, Departamenti i Ankesave i ATK-së (Vendimi nr. 292/2006) refuzoi ankesën si të pabazuar.
13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime (në tekstin e mëtejme: BPR) kundër Vendimit të Departamentit të Ankesave të ATK-së.
14. Më 16 tetor 2006, BPR (Aktvendimi 503/2006) refuzoi ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së.
15. Më 20 nëntor 2006, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të BPR-së.
16. Më 13 nëntor 2008, Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. nr. 3284/2006) aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe ia ktheu lëndën BPR-së për rivendosje.
17. Më 17 shtator 2013, duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, BPR (Aktvendimi A. nr. 503/2006 ATK) vendosi ta refuzojë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe ta vërtetojë Aktvendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së.
18. Në aktvendimin e përmendur të BPR-së, në udhëzimin e mjetit juridik theksohej që parashtruesi i kërkesës *“kundër këtij aktvendimi ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në afatin prej 60 ditësh nga dita e pranimit”*.
19. Më 8 maj 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatën Themelore në Prizren propozimin për përmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 3284/2006.
20. Më 19 shkurt 2015, Gjykata Themelore (Aktvendimi CP. nr. 1070/14) refuzoi propozimin për përmbarim si të pabazuar, duke theksuar se aktgjykimi në të cilin thirret parashtruesi *“nuk përbën dokument të përmbarimit”*.
21. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatën Themelore propozimin e dytë për përmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 3284/2006.
22. Më 14 qershor 2016, Gjykata Themelore (Aktvendimi E. nr. 2664/09) refuzoi si të pabazuar propozimin për përmbarim, duke arsyetuar se *“ky aktgjykim nuk përbën titull ekzekutiv në këtë procedurë të përmbarimit, pasi që në këtë aktgjykim udhëzohet që çështja të rikthehet në riprocedurë për vendosje”*.
23. Më 5 prill 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi në Gjykatën Themelore në Prishtinë padi administrative, kundër ATK-së për anulimin e Vendimit të BPR-së, A. nr. 503/2006-ATK, të 17 shtatorit 2013.
24. Më 11 prill 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi A. nr. 627/17) u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore për vendosjen e çështjes juridike dhe vendosi t'ia dërgoj lëndën Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, si gjykatë kompetente për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

25. Parashtruesi pretendon shkelje të një numri të madh të neneve të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative dhe Rregullores nr. 2002/3 mbi Tatimin në Fitim në Kosovë.
26. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk i referohet asnjë shkelje të të drejtave të tij kushtetuese dhe dispozitave kushtetuese përkatëse.
27. Për më tepër, parashtruesi pretendon se BPR (Aktvendimi nr. 503/2006, i 17 shtatorit 2013) nuk e përmbart Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (A. nr. 3284/2006).
28. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të *“Anullohet Aktvendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime - Prishtinë në Riprocedurë A. nr. 503/2006 ATK, datë 17.09.2013” dhe ATK-ja “të obligohet të bjen vendimin për kthimin e tatimeve të paguar tepër”.*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

29. Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuar me Rregullore të punës.
30. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:  
*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]  
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
31. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili parasheh:  
*“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*
32. Gjykata, më tej, i referohet paragrafit 2, të nenit 47 të Ligjit [Kërkesat individuale], i cili parasheh:  
*“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
33. Gjykata më tej merr parasysh paragrafin (1) (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.*

34. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të parapara më tej në Ligj dhe të specifikuar në Rregullore të punës.
35. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se në Aktvendimin e BPR (A. nr. 503/2006), thuhej që parashtruesi i kërkesës *“kundër këtij Aktvendimi ka të drejtë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në afatin prej 60 ditësh nga dita e pranimit”*.
36. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të BPR-së, edhe pse ndaj këtij aktvendimi mund të ishte parashtruar ankesë sipas ligjit në fuqi dhe udhëzimeve mbi të drejtën e ankesës të dhëna në vetë aktvendimin.
37. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi parashtrroi ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila e deklaroi [Aktvendimi A. nr. 627/17] veten jokompetente dhe i dërgoi lëndën Gjykatës së Apelit si gjykatë kompetente.
38. Në fund, Gjykata konkludon se procedura sipas ankesës në Gjykatën e Apelit është ende në zhvillim e sipër dhe se parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi se Gjykata e Apelit ka marrë një vendim lidhur me ankesën e parashtruesit.
39. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i janë dhënë atij nga ligji i aplikueshëm në Kosovë. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të korrigjohet një shkelje e tillë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI07/09, *Demë dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010, paragrafët 28-29).
40. Arsytimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që t'u ofrojë gjykatave të rregullta mundësinë për ta korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI41/09 *AAB-RIINVEST Universiteti LLC, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010; shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktvendimi i 29 korrikut 1999).
41. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se rregulli i shterimit të mjeteve juridike nga neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës obligon ata që dëshirojnë të paraqesin lëndën e tyre në Gjykatë, që së pari të shfrytëzojnë mjetet efektive juridike të cilat janë të disponueshme sipas ligjit kundër vendimeve të autoriteteve publike që pretendohet se i kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.
42. Gjykata thekson se ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete

juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, *inter alia*, rasti i GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).

43. Gjykata rikujton se mekanizmi i mbrojtjes i themeluar me sistemin kushtetues është subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (Shih rastin e GJEDNJ-së *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 48).
44. Në këto rrethana, Gjykata vëren se procedurat janë në zhvillim e sipër në Gjykatën e Apelit, dhe se ende nuk është marrë një vendim përfundimtar në rastin e parashtruesit të kërkesës.
45. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme pasi ende nuk janë shteruar mjetet juridike në gjykatat e rregullta.
46. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenet 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 shtator 2017, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi